



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1275/12 prot.,

Datë 10.07.2025

V E N D I M
Nr. 888/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.07.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 756/2025, datë 10.06.2025, i korrigjuar me vendimin nr.782/2025, datë 16.06.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Ref-47110-05-06-2025 me objekt: “Kite Reagente për Laboratorët e Shëndetit Publik”, me fond limit 3.500.000 (tremilion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës

Ankimues: Operatori ekonomik “ALMedical” SHPK me NIPT K215110021 dhe adresë: Rruga “Shefqet Musaraj” banesa nr.17, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.
Adresa: Lagjja Nr.4 Rr. “Fetah Bllaca”, Durrës

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 10.06.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 756/2025, ku vendosi: [...]

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK për procedurën e prokurimit me “E hapur e thjeshtuar”, me Ref-47110-05-06-2025 me objekt: “Kite Reagente për Laboratorët e Shëndetit Publik”, me fond limit 3.500.000(tremilion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Ref-47110-05-06-2025 me objekt: “Kite Reagente për Laboratorët e Shëndetit Publik”, me fond limit 3.500.000 (tremilion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës*
3. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK.*
4. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
5. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

[...]”

Në datë 16.06.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 782/2025, ku vendosi: [...]

1. *Të korigjojë pikën 3 të dispozitivit të Vendimin e Nr.756/2025, datë 10.06.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik si më poshtë:*

Ishte

3. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK.*

Bëhet

3. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

[...]

I.3. Me shkresën nr. 240/11 prot., datë 27.06.2025, protokolluar me tonën nr. 1275/9 prot., datë 07.07.2025, autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 756/2025, datë 10.06.2025, i korrigjuar me vendimin nr.782/2025, datë 16.06.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Ref-47110-05-06-2025 me objekt: “Kite Reagente për Laboratorët e Shëndetit Publik”, me fond limit 3.500.000(tremilion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 240/11 prot., datë 27.06.2025, protokolluar me tonën nr. 1275/9 prot., datë 07.07.2025, autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 756/2025, datë 10.06.2025, i korrigjuar me vendimin nr.782/2025, datë 16.06.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Ref-47110-05-06-2025 me objekt: “Kite Reagente për Laboratorët e Shëndetit Publik”, me fond limit 3.500.000(tremilion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e mësipërme duke i bashkëlidhur “Formularin e Njoftimit të Anullimit” botuar në Buletin e Njoftimeve Publike nr.32, datë 23.06.2025.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës e ka zbatuar vendimin Nr. 756/2025, datë 10.06.2025, i korrigjuar me vendimin nr.782/2025, datë 16.06.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Ref-47110-05-06-2025 me objekt: “Kite Reagente për Laboratorët e Shëndetit Publik”, me fond limit 3.500.000(tremilion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Ref-47110-05-06-2025 me objekt: “Kite Reagente për Laboratorët e Shëndetit Publik”, me fond limit 3.500.000(tremilion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Florent Zguro

